



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshor

Kryesia e Kuvendit

P-045

Prishtinë, më 16 nëntor 2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 NËNTOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Slavko Simiq.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Në fillim të mbledhjes, Kryesia, me propozim të kryetarit, e mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi për viktimat e sulmit terrorist në Paris.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës. Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, 1. Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, për seancë të Jashtëzakonshme dhe 2. Kërkesa e 82 deputetëve të Kuvendit për krijimin e kushteve për punë normale në sallën e seancave plenare, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 23, 27, 28, 29 dhe 30 tetor 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 23, 27, 28, 29 dhe 30 tetor 2015

Kryesia i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 23, 27, 28, 29 dhe 30 tetor 2015.

Ndërsa nënkryetarja e Kuvendit znj. Aida Dërguti, pati vërejtje në transkriptin e mbledhjes së mbajtur më 23 tetor 2015, në faqen 16, rreshti 26, në të cilën ishte evidencuar gabimisht: “se më përpara del opozita sesa pozita”, ndërsa ishte dashur të jetë: “se më përpara del pozita sesa opozita”. Transkripti është korrigjuar sipas vërejtjes së dhënë.

2. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbajtje të një seance të jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me të cilën kishte kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit më 17 nëntor 2015, në orën 9:00, për shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me kërkesën e lartpërmendur.

Lidhur me kërkesën e Kryeministri të Republikës së Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme diskutuan: Ismet Beqiri, Aida Dërguti, Adem Grabovci dhe Slobodan Petroviq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia, me katër vota për dhe një kundër (Aida Dërguti), vendosi që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 17 nëntor 2015, në orën 09:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

* * *

Ndërsa pikat e tjera të rendit të ditës për seancë plenare, Kryesia i shtyu për një mbledhje tjetër të radhës.

3. Kërkesa e 82 deputetëve të Kuvendit për krijimin e kushteve për punë normale në sallën e seancave plenare

Kryetari i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e kërkesës së 82 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës adresuar Kryesisë dhe institucioneve përgjegjëse të sigurisë, me të cilën kanë kërkuar krijimin e kushteve normale për punë në sallën e seancave plenare të Kuvendit.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: Aida Dërguti, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se kërkesën e 82 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me një shkresë përcjellëse, do t'ua adresojë institucioneve përgjegjëse sigurisë.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

2. Raportet e shpenzimeve tremujore, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera për derivate, për dreka e darka, për udhëtime brenda dhe jashtë vendit të publikohen në ueb-faqen e Kuvendit.

2. Njoftimi i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për pjesëmarrjen në Sesionin e 60-të vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Kryesia u njoftua me raportin e nënkryetarëve të Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Slobodan Petroviq, lidhur me pjesëmarrjen e tyre në Sesionin e 60-të vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili është mbajtur në Norvegji, prej 9-13 tetor 2015.

me vizitën zyrtare të realizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë prej 15-16 tetor 2015.

4. Njoftimi i katër (4) deputeteve të Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në SHBA

Kryesia u njoftua me raportin e deputetëve e Kuvendit, znj. Doruntinë Maloku, znj. Valdete Bajrami, znj. Luljeta Veselaj Gutaj dhe znj. Jelena Bontiq, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në SHBA, prej 28 shtator deri më 9 tetor 2015.

Të ndryshme:

Në fund të mbledhjes, kryetari i Kuvendit theksoi se është një qëndrim i Kryesisë së Kuvendit që çdo deputet i cili mungon në seancën plenare të datës 17 nëntor 2015 do të konsiderohet që mungon pa leje, ngase ishin anuluar të gjitha udhëtimet zyrtare jashtë vendit për ditën e sotme dhe të nesërme.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 13:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale